



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 shkurt 2013
Nr. ref.: RK382/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI124/11

Parashtruesi

Ljubiša Živić

Kërkesë për vlerësimin e procedurave ankimore në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Vushtrri, K66/09, e 25 majit 2010 (stërzgatje e procedurës)

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Ljubiša Živić, me vendbanim në Graçanicë.

Objekti i çështjes

- Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, nga parashtruesi, është pretendimi për zgjatje të paarsyeshme të procedurave ankimore penale kundër Aktgjyqimit të Gjykatës Komunale në Vushtrri, K66/2009, të 25 majit 2010. Ajo procedurë penale ishte iniciuar ndaj të akuzuarit D.D. Parashtruesi është palë e interesuar në procedurë.
- Parashtruesi konsideron se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 dhe me nenin 4 [Barazia para Ligjit]; me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; si dhe me nenin 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme], të Kushtetutës.

Baza juridike

- Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

- Më 19 shtator 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
- Më 7 shkurt 2012, Kryetari i Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Enver Hasani dhe Gjyljeta Mushkolaj.
- Më 18 janar 2012, Gjykata njoftoi parashtruesin, Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe Gjykatën Komunale në Vushtrri, për kërkesën.
- Më 12 nëntor 2012, Kryetari caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu për të zëvendësuar gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj.
- Më 21 nëntor 2012, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

- Në kërkesën e tij, parashtruesi pretendon: “Edhe pse kanë kaluar 16 muaj, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë nuk ka caktuar seancë për rastin me numër K66/09, me ç’rast ka shkelur të drejtat tona kushtetuese dhe të drejtën për gjykim të drejtë”.
- Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese që “të caktojë procedurën në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë dhe të sigurojë marrjen e vendimit final për rastin”.

Përmbledhja e fakteve

- Parashtruesi nuk ka specifikuar ndonjë fakt të rastit, përveç pretendimeve të theksuara më lart.
- Nga dokumentet e dorëzuara në mbështetje të kërkesës, mund të vërehen faktet që janë në vijim.
- Më 25 maj 2010, Gjykata Komunale në Vushtrri nxori Aktgjykimin K66/09, në procedurën penale kundër të akuzuarit D. D., i cili u shpall fajtor për veprën penale prezantim i rremë, nga neni 325 i Kodit Penal të Kosovës (KPK); për veprën penale rastet e posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 333.4 i KPK-së; dhe për veprën penale mashtrim në votime nga neni 180 i KPK-së.

15. Nga aktgjykimi vërehet se i akuzuari D. D. ishte dënuar me 12 (dymbëdhjetë) muaj burgim dhe ishte gjobitur me 1.300 (një mijë e treqind) euro.
16. Gjithashtu, vërehet nga Aktgjykimi K66/99 i Gjykatës Komunale në Vushtrri, se parashtruesi ishte përmendur si palë e dëmtuar në procedurën penale.
17. Në një datë të pacaktuar, avokati mbrojtës i të akuzuarit D. D. ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, duke pretenduar shkeljen e të drejtës penale materiale dhe procedurale.
18. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga parashtruesi, më tej, vërehet se ai nuk ka dorëzuar ndonjë parashtrësë me shkrim apo gojarisht për procedurën penale kundër të akuzuarit D. D.

Ligji i zbatueshëm

19. Neni 151 i Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK, Ligji Nr. 2003/26), në Kapitullin XVIII përshkruan kuptimin e shprehjes juridike të termit “pala e dëmtuar” si vijon: *“Sipas këtij Kodi: ‘I dëmtuar’ është personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur”.*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
22. Gjykata, gjithashtu, merr parasysh rregullin 36 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese, që përcakton:

*“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) kërkesa është qartazi e pabazuar”.*
23. Ashtu siç është përmendur më herët, argumenti kryesor i parashtruesit është se i është shkelur e drejta për gjykim të drejtë, sepse kanë kaluar 16 muaj dhe Gjykata e Qarkut në Mitrovicë nuk ka caktuar seancë për rastin penal me numër K66/09 ndaj D. D.-së.
24. Gjykata vëren se, në këtë rast, parashtruesi i kërkesës nuk provon “statusin e viktimës të shkaktuar nga autoriteti publik”, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 34 Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (*Shih, mutatis mutandis, Lindsay kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 31699/96, Vendimi i Komisionit i 17 janarit 1997, 23 E. H. R. R.; Agrotexim dhe të tjerët kundër Greqisë, Aktgjykimi i 24 tetorit 1995, Seria A, nr. 330-A, pp. 22-26, §§ 59-72; dhe Aktvendim për papranueshmëri në Rastin Nr. KO43/10, parashtrues të kërkesës LDK-AAK-LDD, Vlerësim i kushtetutshmërisë së akteve juridike të nxjerra nga Kryetari i Prizrenit, i 25 tetorit 2011).*
25. Gjykata rikujton se viktimë konsiderohet personi fizik ose juridik (*Shih rastin Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti Nr. KI41/09*), të cilit personalisht ose drejtpërdrejt i preken të drejtat e njeriut nga masat apo nga aktet e autoriteteve publike. Personi që nuk është prekur në këtë mënyrë, nuk e ka statusin e viktimës, pasi që Kushtetuta nuk parasheh *actio popularis*.

26. Rrjedhimisht, në pajtim me rregullin 36.2.c të Rregullores së punës, Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar “nëse bindet se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë”.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe në mbështetje të rregullit 36.2.c të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme,
- II. T’UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Prof. dr. Ivan Čukalo



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani